

Në pajtim me nenin 36 të Ligjit për qasje të lirë në informacionet me karakter publik (“Gazeta zyrtare e R.M.V. nr. 101/2019) Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me seli në Bul. “Krste Misirkov” nr. 8 në Shkup, telefon 02 3136-044 dhe e-mail: info@vsrm.mk ,, përmes personit zyrtar për ndërmjetësim të informacioneve me karakter publik Mr. Snezhana Dimitrovska, përgatiti si vijon:

RAPORT VJETOR
(nga 1.01.2021 deri më 31.12.2021)

1. Të dhënat për personat zyrtar të caktuar për ndërmjetësim me informacionet te poseduesit e informacioneve;

Mr. Snezhana Dimitrovska, bashkëpunëtore e lartë gjyqësore
e-mail: snezana.dimitrovska@vsrm.mk

2. Numri i kërkesave të pranuar;

Në periudhën prej datës 01.01.2020 deri më datë 31.12.2020 në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë pranuar gjithsej njëzet e nëntë (29) kërkesa për qasje të lirë në informacione me karakter publik. Nga kërkesat e pranuar dymbëdhjetë (12) janë parashtruar nga persona juridik ndërsa 17 janë parashtruar nga persona fizik.

3. Numri i kërkesave me përgjigje pozitive;

Përgjigje pozitive me aktvendim janë njëzet (20) kërkesa.

Dy (2) kërkesa u janë ridërguar poseduesve të informacioneve sipas përmbajtjes së kërkesës në përputhje me nenin 18 paragrafi 1 të Ligjit për qasje të lirë në informacione me karakter publik, për të cilat është dërguar njoftim drejt kërkuarëve.

Për tre (tre) kërkesa të parashtruara nga persona fizik lidhur me lëndë konkrete në të cilat kërkuarët e informacioneve ishin palë në procedurë, iu dërguan përmes e-mail adresës njoftime parashtruesve të kërkesave.

Për katër (4) kërkesa për qasje të lirë në informacione me karakter publik të parashtruar nga një person fizik, të cilat u ridërguan në Gjykatën Supreme nga ana e një gjykate tjetër duke u thërritur në nenin 18 të Ligjit për qasje të lirë në informatat me karakter publik, parashtruesit të kërkesës i është dhënë përgjigje me njoftim me shkrim duke qenë se kërkesat kishin të bëjnë për lëndë konkrete mbi të cilën ka vepruar Gjykata Supreme, në të cilën parashtruesi ka qenë palë.

4. Numri i kërkesave të refuzuara dhe të hedhura poshtë me theksimin e arsyeve për çdo kërkesë të refuzuar ose të hedhur poshtë;

Kërkesa të refuzuara dhe të hedhura poshtë nuk ka.

5. Numri i kërkesave pa përgjigje

Mbi të gjitha kërkesat për qasje të lirë në informacione me karakter publik të pranuar në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë periudhës raportuese është vepruar dhe përgjigjur. Kërkesa pa përgjigje nuk ka.

6. Numri i ankesave të parashtruara kundër vendimeve të shkallës së parë (aktvendimet e poseduesve të informacioneve, me përshkrimin e vendimit, si dhe me theksimin e arsyeve për vendimin e miratuar në rast të refuzimit përsëri të informacionit të kërkuar);

Në periudhën raportuese drejtuar Agjencisë për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacionet me karakter publik ishte parashtruar një (1) ankesë nga një person fizik kundër Gjykatës Supreme për lëndë të titulluar kërkesë për qasje të lirë në informacion me karakter publik, për shkak se, siç ishte theksuar në ankesën, Gjykata Supreme nuk ka vepruar mbi kërkesën e parashtruesit në afat të paraparë ligjor.

7. Numri i ankesave të miratuara me vendim të Agjencisë;

Nuk ka ankesa të miratuara me vendim të Agjencisë.

8. Numri i vendimeve të ndryshuara të shkallës së parë pas veprimit të Agjencisë

Nuk ka vendime të ndryshuara pas veprimit të Agjencisë.

9. Numri i ankesave të refuzuara nga Agjencia dhe shkaqet për refuzimin e tyre dhe

Nuk ka ankesa të refuzuara nga Agjencia.

10. Numri i ankesave të hedhura poshtë nga Agjencia dhe shkaqet për hedhje poshtë të tyre.

Në periudhën raportuese nga ana e Agjencisë për mbrojtjen e të drejtave për qasje të lirë në informacionet me karakter publik është hedhur poshtë një (1) ankesë.

Ankesa e theksuar në pikën 6 të këtij raporti, e parashtruar nga një person fizik kundër Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Agjencia për mbrojtjen e të drejtave për qasje të lirë në informacione me karakter publik, me aktvendim 08- 770 të datës 22.11.2021, e ka hedhur poshtë si të palejuar, ngase ka konstatuar se kërkesa e personit fizik e parashtruar në Gjykatën Supreme nuk paraqet kërkesë për qasje të lirë në informacione me karakter publik, por është kërkesë nga kompetenca e Gjykatës, me sugjerim për atë se cili është qëllimi i Ligjit për qasje të lirë në informacionet me karakter publik dhe se të drejtat e tyre dhe interesat private (personale) ankuesi mundet dhe duhet t'i realizojë para se gjithash sipas ligjeve materiale që e rregullojnë materien adekuate në lëndët në të cilat paraqitet si palë dhe mbrojtje juridike mund të kërkojë sipas atyre ligjeve.

SUGJERIM: Sipas Planit Aksionar Nacional për Partneritet të Hapur me Qeverinë dhe angazhimin Согласно Националниот акциски план за Отворено Владино Партнерство и заложбата „Publikimi në mënyrë proaktive i informacioneve me karakter publik në faqet e internetit të institucioneve”, në Shtesë të Raportit Vjetor, personat zyrtar të poseduesve të informacioneve me karakter publik duhet ti fusin linqet deri në 22 kategoritë e dokumenteve që përfshihen në nenin 10 nga Ligji për qasje të lirë në informacione me karakter publik. Ky sugjerim iu referohet poseduesve të informacioneve me karakter publik që kanë internet faqe.

1. Të dhënave nga kompetencat e veta të cilat i kryen, përkatësisht i janë përcaktuar me ligj, <http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/za-sudot/opsti-podatoci/>
2. Të dhënave themelore për kontakt me poseduesit e informatës edhe atë: emrit, adresës, numrit të telefonit, numrit të faksit, e-mail adresës së faqes së internetit, <http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/kontakt/za-sudot/>

3. Të dhënave për funksionarin ose personin përgjegjës të poseduesit të informatës (biografi, të dhëna për kontakt etj.),
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/za-sudot/za-sudiite/>
4. Të dhënave themelore për kontakt me personat zyrtar për ndërmjetësim me Informata edhe atë: emri dhe mbiemri, e-mail adresa dhe numri i telefonit,
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/kontakt/sloboden-pristap/>
5. Të dhënave themelore për kontakt me personin e autorizuar për paraqitje të brendshme të mbrojtur edhe atë: emrin dhe mbiemrin, e-mail adresën dhe numrin e telefonit,
6. Listës së personave të punësuar të poseduesit të informatës me pozitë, e-mailit zyrtar dhe telefonit zyrtar,
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/za-sudot/za-sudiite/>
7. Ligjeve të cilat kanë të bëjnë me kompetencën e poseduesit të informatave, lidhur me regjistrin e rregullave të publikuara në gazetën zyrtare,
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/za-sudot/opsti-podatoci/>
8. Rregullave që në kuadër të kompetencës së vet i miraton poseduesit të informatës në lloj të aktit nënligjor: rregullore për organizim të brendshëm, rregullore për sistematizimin e vendeve të punës, rregullore për paraqitje të brendshme të mbrojtur etj.), dekrete, urdhëresa, udhëzime, plane, programe, aktvendime dhe lloje tjera të akteve për realizimin e ligjeve dhe rregullave tjera, kur për atë janë të autorizuar me ligj,
со закон,
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/za-sudot/opsti-podatoci/>
9. Organogramit për organizim të brendshëm,
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/za-sudot/vnatresna-org/>
10. Planeve strategjike dhe strategjive për punë të poseduesve të informatave,
11. Planeve vjetore dhe programeve për punë,
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/za-sudot/godisen-plan/>
12. Buxhetit vjetor dhe llogarisë përfundimtare,
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/izvestai/>
13. Planeve vjetore financiare sipas tremujorëve dhe programeve për realizimin e buxhetit,
14. Raportit të revizionit,
15. Llojeve të shërbimeve të cilat i japin poseduesit të informatave (informata për qasjen fizike për realizimin e shërbimeve dhe informatave për e-shërbimet, të dhënat për bazat ligjore, emrin e shërbimeve, dokumentet dhe të dhënat e nevojshme për realizimin e secilit shërbim, mekanizmat për mbrojtje juridike dhe të dhëna tjera relevante),
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/formulari/drugi-baranja/>
16. Listat tarifore për kompensimet për lëshimin e akteve reale,
17. Mënyrën e parashtrimit të kërkesës për qasje të informatat (mënyra e parashtrimit e kërkesës me

gojë dhe me shkrim për qasje të informatat, si dhe kërkesë e parashtruar në formë elektronike),
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/kontakt/sloboden-pristap/>

18. Dokumentacionit të plotë për prokurimet publike, për koncesionet dhe për marrëveshjet për partneritet privat – publik,
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/za-sudot/javni-nabavki/>
19. Propozim – programeve, programeve, qëndrimeve, mendimeve, studimeve dhe dokumenteve tjera të ngjashme të cilat kanë të bëjnë me aktet nga kompetenca e poseduesit të informatave, njoftimeve për publikun për punët e ndërmarra nga internet faqja e tyre në pajtim me kompetencat ligjore, buletine informative, gazeta zyrtare nëse janë obligim në pajtim me ligj e të tjera,
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/sudska-praksa/nacelni-mislenja/>
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/sudska-praksa/nacelni-stavovi/>
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/sudska-praksa/pravni-mislenja/>
<http://www.vrhoven.sud.mk/VSUD/MatraVSUD.nsf/PravnaPodelba.xsp>
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/publikacii/bilteni/>
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/publikacii/zbirki/>
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/vesti/>
20. Raporteve për punë të cilat i parashtrojnë te organet kompetente për zbatimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes,
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/izvestai/svi/>
21. Të dhënave statistikore për punën, si dhe informatave tjera, akteve dhe masave me të cilat ndikohet mbi jetën dhe punën e qytetarëve dhe të cilat dalin nga kompetenca dhe puna e poseduesit të informatave dhe
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/izvestai/statistika/>
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/kontakt/rabotno-vreme/>
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/kontakt/posebni-potrebi/>
22. Informatave tjera të cilat dalin nga kompetenca dhe puna e poseduesit të informatës.
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/kontakt/odnosi-javnost/>
<http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/kontakt/portparoli/>

Shkup, 24.01.2022

**GJYKATA SUPREME E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

Person zyrtar për ndërmjetësim
me informatat me karakter publik
Mr. Snezhana Dimitrovska